

Lenda : Probleme te pergjitheshme dhe propozime ne frtikulture.

Drejtuar zv/ Ministrit te Bujqesise

z. Alban ZUSI

Probleme te prodhimit

1. Dominimi i teknologjise ekstensive sepse pas viteve 2007 jane mbjelle pemetore ekstensive me distanca te medha dhe varietete tradicional, megjithese fermat . Pemetoret ekstensive zene rreth 90 % te siperafaqes dhe varietetet tradicional zene rreth 95 %. Pemetoret ekstensive kane rendiment i ulet, (tek molla 160 kv/ha ndaj 450 kv/ha tek pemetoret intensive), kosto e larte e prodhimit, cilesi e dobet frutash dhe veshtiresi ne tregtim. Subvensioni apo investimet ne frutikulture nuk jane shoqeruar me asistence tekniko-ekonomike dhe nuk jane rentabel.
2. Fermeret nuk njohin teknikat e reja, si te krasitjes, mbrojtjen fitosanitare, ujitjen etj. dhe per rrjedhoje nuk marrin rendimentin, prodhimin dhe te ardhurat e duhura.
3. Demtim te prodhimit nga bresheri (ne Korçe ka frekuence te larte shfaqje), dhe nuk sigurojne prodhimin e frutave dhe prodhuesi eshte i pambrojtur.

Probleme te pasvjeljes

1. Molla ne vendin tone ruhet ne dhomat frigoriferike te zakonshme deri ne 6 muaj (tetor-mars) dhe pas kesaj periudhe demtohet prodhimi. Mungon teknologjia me Atmosfere te Kontrolluar (AC), qe ruan mollen deri 12 muaj.
2. Demtim te prodhimit te molles, kjo per shkak se 30 % e prodhimit te molles ose rreth 20 mije ton ne vit eshte e cilesise se dobet, i cili duhet te perpunohet, por perdoret per treg dhe shitet lire ose demtohet. Nuk ka linja te perpunimit te molles qe te perballojne kerkesat per perunim. Ka nje linje per prodhimin e lengut te molles ne Korçe (FrutAl), por lengu i molles priset dhe ka probleme me tregun.
3. Demtim te prodhimit te kumbulles ose shitje me cmim shume te lire, per shkak te mungeses se objekteve te magazinimit dhe te perpunimit. Subvensionet e dhena ne Diber per perpunimin e kumbulles per prodhim kumbulle te thate dhe qershise nga AZHBR jane ne proces te zgjidhjes se kontrates, sepse nuk kane arrit te dalin ne treg per shkak te demtimit te linjat e instaluar jane te teknologjise se vjeter dhe nuk jane shoqeruar me asistence teknike.
4. Demtim i frutit te sheges sepse ai qendron i fresket ne treg 15-20 dite dhe nuk ka dhoma frigoriferike.

Probleme te organizimit:

1. Prodhuesit nuk arrijne te zgjidhin ne menyre individuale keshillen teknike te specializuar, hartimin dhe zbatimin e projekteve.
2. Nuk eshte i organizuar tregu, shume prodhues shesin direkt vete dhe ndikojne keq ne cmimin e shitjes te frutave dhe çmimi imponohet nga tregtaret.

Propozime per zgjidhje

1. Te permiresohet teknologjia ekzistuese dhe te nxitet teknologjia e re
2. Mbeshtetje per shoqerimin e projekteve nga organizatat profesionale per masen e prodhuesve
3. Nje strategji per perpunimin e molles, duke mbeshtetur disa inisiativa per linja me kapaciete te vogla
4. Teknologjia e re ne ruatje smartFresh dhe Atmosfere te kontrolluar AC
5. Te testohet teknika per vendosjen e antibresherit
6. Te mbeshteten prodhues te cilet jane te gatshem te marrin pjese per sigurimin e prodhimit

DREJTORI

Hafuz DOMI